

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
KËSHILLIN E QARKUT VLORË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në Këshillin e Qarkut Vlorë, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2013 deri më 30.10.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 14, datë 20.02.2016

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 999/9 datë 22.02.2016, i ka rekomanduar z. Sadrit Danaj, Kryetar i Këshillit të Qarkut Vlorë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1.Gjetje: Nuk kanë gjetur zbatim të gjitha rekomandimet e lëna në auditimit e mëparshëm të KLSH-së, dërguar me shkresë nr. 497/7, datë 30.3.2010. Konkretisht, nuk është zbatuar masa për shpërblim dëmi, pasi nuk i është kërkuar shoqërisë “D...a”, shpërblimi i dëmit me vlerë 323,360 lekë, si dhe nuk është zbatuar masa administrative për arkëtimin e gjobës në vlerën 500,000 lekë, nga kooludatori i punimeve të objektit “*Riparim Rrugësh rurale Vlorë*”.

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë, të marrë masat e nevojshme administrative dhe ligjore për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të rekomanduara me shkresën nr. 497/7, datë 30.3.2010.

Menjëherë

2. Gjetje: Nuk janë implementuar të gjitha kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”. Konkretisht: nuk është caktuar koordinatori i riskut, nuk janë evidentuar risqet dhe nuk është përpiluar strategjia për menaxhimin e tij, nuk janë miratuar gjurmët për auditim, nuk janë identifikuar zonat me risk, nuk është hapur regjistri i riskut ku të regjistrohen raportimet dhe masat e marra për parandalimin e mashtrimit dhe parregullsive si dhe nuk janë përcaktuar rregulla për administrimin dhe ruajtjen e aktiveve të qëndrueshme.

2.1.Rekomandimi: Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë, të marrë masat e nevojshme administrative dhe ligjore për implementimin e plotë të të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”.

Vazhdimisht

3. Gjetje: Shpenzimet buxhetore të Këshillit të Qarkut mbulohen nga financimet qeveritare që i jepen nëpërmjet granteve të pa kushtëzuara dhe nga kuotat e kontributeve që do të derdhen njësitë vendore të juridiksionit të saj. Në vitin 2013, plani i buxhetit ishte parashikuar në shumën 159,178,000 lekë, u realizuar në masën 90,302,000 lekë ose 57 %; mosrealizimi ka ardhur kryesisht nga mos derdhja e kontributeve të njëjësive vendore në shumën 62,379,000 lekë. Në vitin 2014, ishte parashikuar në shumën 156,548,000 lekë, u

realizuar në masën 101,656,000 lek ose 65%; mosrealizimi ka ardhur kryesisht nga mos derdhja e kontributeve të njërive vendore në shumën 39,205,000 lekë. Në 9 mujorin e vitit 2015, plani i buxhetit ishte parashikuar në shumën 171,468,000 lekë, u realizuar në shumën 101,656,000 lekë ose 59%, edhe në këtë periudhë mosrealizimi ka ardhur kryesisht nga mos derdhja e kontributeve të njërive vendore në shumën 76,118 lekë. Duket qartë se, Këshilli i Qarkut nuk ka realizuar planin e buxhetit sepse nuk ka mundur të realizojë të ardhurat që do të përfitoheshin nga derdhja e kontributeve të njërive vendore. Si pasojë e mungesës së këtij financimi, në çdo vit buxhetor janë krijuar detyrime afatshkurtra (shpenzime të pa likuiduara) për paga, sigurime shoqërore e shëndetësore, furnitura të ndryshme, etj. Planifikimi i shpenzimeve të buxhetit duke mos njohur gjendjen faktike të të ardhurave dhe shpenzimeve të njërive vendore, tregon për formalizëm në planifikimin e treguesve të buxheteve dhe burimeve të financimit, veprim ky në kundërshtim me kërkesat e UMF nr 2, datë 06.02.2012 “*Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit*”.

3.1. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Vlorë, të analizojë gjendjen ekonomike dhe financiare dhe buxhetet reale të njërive vendore dhe në bazë të të ardhurave faktike që kanë derdhur këto njësi vendore si kontribut në këshillin e Qarkut në vitin e mëparshëm, të planifikojë shpenzimet e Këshillit të Qarkut për vitin e ardhshëm.

Vazhdimisht

3.2. Rekomandimi: Këshilli i Qarkut Vlorë, të marrë masat e nevojshme për të përmirësuar aftësitë paguese dhe shlyerjen graduale të detyrimeve të krijuara.

Vazhdimisht

4. Gjetje. Këshilli i Qarkut, në vitet 2013 dhe 2014 ka realizuar vetëm procedurën e prokurimit për “Blerje karburanti”, respektivisht për vitin 2013 me fond limit 904,821 lekë, dhe për vitin 2014 me fond limit 902,369 lekë. Ndërsa në periudhën janar-tetor 2015 ka realizuar 4 procedura prokurimi me fond limit të përgjithshëm 28,418,994 lekë. Në 3 procedura të realizuara gjatë vitit 2015 u konstatuan shkelje të rregullave të prokurimit publik, me pasojë përdorim fondesh pa efektivitet në vlerën totale 2,670,716 lekë. Konkretisht:

1. Për llogaritjen vlerave të kontratave, në procedurat e prokurimeve për: “Pikën panoramike dhe sportive në Llogora” me fond limit 14,094,359 lekë, “*Krijimin e një shtegu Trekking në kanionin e Gjipesë*”, me fond limit në vlerën 7,837,835 lekë dhe “*Përmirësimin i kushteve të banesave për komunitetin “Rom-Egjiptian”*” me fond limit në vlerën 5 milion lekë, për disa zëra pune të preventivave, të cilat nuk janë përfshirë në manualin teknik të çmimeve të miratuar me VKM, çmimet e këtyre zërave janë përcaktuar në bazë të analizave teknike të çmimeve. Për llogaritjen e vlerës së kontratës, AK nuk duhej të mjaftohej vetëm me hartimin e analizës së çmimeve, por duhej të ngrinte grup pune për studimin e çmimeve alternativave, duke ju referohej rasteve të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Dhe mbas studimit të këtyre çmimeve të llogariste vlerën e kontratës në bazë të çmimeve që ishin më me leverdi ekonomike.

2. Në procedurën “*Pikë panoramike dhe sportive në Llogora*” me fond limit 14,094,359 lekë, AK ka hartuar dhe vendosur në DT të këtyre procedurave, kriteret e veçanta kualifikuese. Disa nga këto kritere nuk janë përcaktuar në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën kontratës që do të prokurohet dhe janë diskriminuese, sepse janë hartuar teje të fryra dhe kufizuese si dhe nuk stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm. Veprime këto, në kundërshtim, me

rregullat e prokurimit publik. Këto shkelje janë bërë shkak që KVO-ja gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave ka s`kualifikuar operatorët, “B...”, “Gj...a” dhe “Sh...i&F...i”, të cilët kanë paraqitur ofertat më të ulëta ekonomikisht se operatori fitues “A...i”, me diferencë të që shkon nga 246,791 lekë në 1,924,282 lekë. Si pasojë e këtyre shkelje janë përdorur fonde pa efektivitet në vlerën **2,309,138, lekë**.

3. Edhe në procedurën “*Krijimi i një shtegu Trekking në kanionin e Gjipesë*”, me fond limit në vlerën 7,837,835 lekë, AK ka hartuar dhe vendosur kriteret e veçanta në kundërshtim, me rregullat e prokurimit publik. Këto, shkelje janë bërë shkaqe për s`kualifikime e të gjithë operatoreve pjesëmarrës (4 operatorë) në këtë procedurë, për pasojë nuk është siguruar konkurrenca, duke e çuar këtë procedurë në anulimin e saj. Po kështu është vepruar edhe në procedurën e përsëritur, duke e çuar përsëri këtë procedurë në anulim. AK, nuk ka analizuar shkaqet, që shkaktuan dështimin e procedurës së parë, dhe nuk ka korrigjuar kërkesat e veçanta në mënyrë, që të bëjë të mundur rritjen e konkurrencës, pasi kriteret e veçanta të përcaktuara në DT në të dy procedurat vijuese janë të njëjta si të procedurës së parë, çka ka bërë që procedura të anulohet dy herë rresht dhe të realizohet mbas herës së tretë ose mbas 50 ditëve, në vend që të realizohej mbas 10 ditëve, në kundërshtim, me rregullat e prokurimit publik. Nga këto veprime apo mosveprime nuk është përmbushur qëllimi i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*” në lidhje me mirë përdorimin e fondeve, pasi janë përdorur fonde pa efektivitet në vlerën **361,578 lekë**. Mungesa e efektivitetit, llogaritet nga diferenca e ofertës ekonomike të operatorit fitues “M...S”, me diferencën ofertës ekonomike në vlerën të operatorit “S...K”, i cili u s`kualifikua nga KVO padrejtësisht në procedurën e parë të datës 15.06.2015.

4.1.Rekomandim: Për çdo procedurë prokurimi, në përlllogaritjen e vlerave të kontratave të ngrihet grup pune për studimin e çmimeve alternativave të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik dhe të merren në konsideratë, çmimet që janë më me leverdi ekonomike.

Vazhdimisht

4.2. Rekomandim: Këshilli Qarkut Vlorë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, për çdo procedurë prokurimi që do të kryhej, të shmang vendosjen e kërkesave diskriminuese. Kriteret e veçanta të hartohen, duke mos vendosur kufizime dhe pengime të pa arsyeshme, me qëllim stimulimin e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të çdo operatori ekonomik që kryhen veprimtari ndërtuese, në të gjithë territorin e vendit.

Vazhdimisht

4.3. Këshilli Qarkut Vlorë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, për çdo procedurë prokurimi që anulohet për shkak të mungesës së konkurrencës, para se ta rishpalli procedurën edhe një herë, duhet të analizojë shkaqet që dështuan procedurën e parë, të nxjerri përgjegjësitë përkatëse dhe të korrigjoje dokumentet e tenderit të procedurës që do të rihapet.

Vazhdimisht

5. Gjetje. Në fillim të vitit 2014, ka përfunduar ndërtimi i Landfilldit të Delvinës për grumbullimin e mbetjeve urbane. Ky landifillid është financuar nga Banka Botërore (BB), me vlerë rreth 6 milion USD. Të gjitha procedurat për ndërtimin janë kryer para viti 2014 nga vetë Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit (MZHUT). Përfitues të këtij investimi do të ishin njësitë vendore: Sarandë, Himarë, Konispol, Delvine, Finiq. Sipas raportit të konsulentit të kontraktuar nga MZHUT, pas shumë takimeve dhe diskutimeve,

ndërmjet përfaqësuesve të njërive vendore dhe BB nuk u gjet dakortësia për krijimit e një shoqërie të përbashkët për menaxhimin e mbetjeve urbane. Problematikat kryesore kanë qenë, kosto e lartë e tarifës së hyrjes në landfillt që do të paguanin këto njësi vendore. Në këto kushte, KQV, me miratimin e BB dhe të MZHUT mori përsipër të menaxhojë vetë mbetjet urbane që prodhojnë këto njësi vendore. Për këtë ka marrë Vendimin nr. 39, datë 19.11.2014, për krijimin e një shoqërie aksionare të emërtuar “B...D”. Kapitali themeltar i shoqërisë është 9,453,000 lekë, me aksionarë të vetëm KQV. Kapital fillestar është derdhur pjesërisht në para në vlerën 3,750,000 lekë. Sipas statutit, të përgatitur dhe hartuar nga konsulenti, objekti i themelimit të kësaj shoqërie përveç menaxhimit të mbetjeve urbane do të jetë edhe riciklimi i tyre. Po kështu në muajin mars të vitit 2015, KQV, ka marrë përsëri një vendim për menaxhimin e mbetjeve urbane edhe të Bashkisë Vlorë, në një kohë që ndërtimi i landfilldit për këtë bashki akoma nuk ka filluar. Të ardhurat e shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit të saj do të jenë nga tarifat e hyrjes që do të paguajnë njësitë vendore të këtij Qarku, për depozitimin e mbetjeve urbane. Konkretisht, sipas plan-biznesit të përgatitur nga konsulenti, çmimi për ton i mbetjeve urbane është përcaktuar 14 USD ose 1,400 lekë. Hyrjet për vitin e parë janë parashikuar gjithsej 53,700 ton. Të ardhurat për vitin e parë sipas këtij parashikimi do të ishin 75,180,000 lekë. Ndërsa shpenzimet në total, do të ishin rreth 20 milion lekë. Pra, shoqëria që në vitin e parë ishte parashikuar që do të dilte me fitim prej 55 milion lekë. Mirëpo u konstatua se:

1. Vlera në natyrë e këtij landfilli prej 6 milion lekë, nuk është përdorur për regjistrim në kapitalin themeltar të shoqërisë, por një pjesë e kapitalit themeltar për krijimin e shoqërisë është mbuluar dhe derdhur pjesërisht në para në vlerën 3,750,000 lekë nga fondet e buxhetit të KQV. Edhe pse landfilli është vënë në shfrytëzim nga shoqëria, deri në fund të shtatorit 2015, shoqëria “B...D”, apo KQV, nuk kanë marrë në dorëzim inventarin e landfilldit, të financuar nga BB me vlerë 5 milion USD, si dhe nuk kanë marrë në dorëzim, pajisjet dhe makineritë që do të përdoren në landfill, të financuara edhe këto nga BB në vlerën 1 milion USD. Po kështu, nuk janë kryer veprime kontabël për regjistrimin në pronësi të shoqërisë të landfilli dhe të pajisjeve dhe makinerive.

2. Mbas krijimit të shoqërisë, gjatë vitit 2015 është negociuar për çmimin e mbetjeve urbane dhe janë lidhur marrëveshjet me 5 njësitë vendore të mësipërme. Këto njësi kanë pranuar çmimin në rritje që do paguajnë për depozitimin e mbetjeve urbane prej 1,500 lekë /toni, pa TVSH. Por, u konstatua së, deri në fund të shtatorit 2015, asnjë njësi vendore edhe pse kanë depozituar mbetjet urbane në këtë landfill nuk kanë paguar tarifën e hyrjes në landfill. Kështu nga të dhënat e bilancit të shoqërisë (llogaria klientë) evidentohet se, në këtë vend-grumbullim gjatë periudhës 9 mujore (janar-shtator 2015), nga të 5 njësit vendore janë depozituar 1,539 ton mbeturina urbane, me vlerë totale 2,769,670 lekë. Duket qartë se parashikimet e grumbullimit të mbetjeve urbane, janë teje larg me çka kanë hyrë në landfill, pasi ishte parashikuar që në 9 muaj të hynin rreth 40 mijë ton, në fakt kanë hyrë vetëm 1,539 ton; edhe për këtë sasi nuk janë paguar tarifat e hyrjes. Në këto kushte, për mungesë të ardhurash, aktiviteti ekonomik financiar i shoqërisë që nga krijimi në datën 10.12.2014 dhe deri në fund të shtatorit 2015 është mbuluar nga grandit i KQV që ka derdhur në shoqëri në formën e kapitalit themeltar në vlerën 3,750,000 lekë.

3. Kjo shoqëri u krijua me synim grumbullimin, menaxhimin dhe riciklimin e mbetjeve urbane që prodhojnë të gjitha njësitë vendore të Qarkut Vlorë, por shoqëria jo vetëm që

nuk e ka përmbushur këtë synim, por nuk ka qenë në gjendje të grumbulloje mbetjet urbane nga njësitë vendore duke mos realizuar asnjë lekë të ardhura, për pasojë shpenzimet për aktivitetin i saj janë mbuluar nga fondet e KQV, buxheti i të cilës financohet nga grandit qeveritar dhe nga kontributet që derdhen vetë këto njësi vendore në buxhetin e KQ.

5.1. Rekomandim. Shoqëria “B...D” dhe Këshilli i Qarkut, Vlorë, të ngrënë komision të posaçëm për marrjen në dorëzim të, landfilldit, të pajisjeve dhe makinerive të financuara nga BB në vlerën 6 milion USD, dhe të bëhet regjistrimet përkatëse në kontabilitetin e shoqërisë.

Menjëherë

5.2. Rekomandim. Shoqëria “B...D” dhe Këshilli i Qarkut, Vlorë, të ri negociojnë me njësitë vendore për uljen e çmimit të mbetjeve urbane.

Menjëherë

5.3. Rekomandim. Meqenëse shoqëria “B...D”, dhe KQV si aksionar i vetëm, nuk janë në gjendje të menaxhojnë grumbullimin e mbetjeve urbane të prodhuara nga këto njësi vendore, të cilat janë edhe përfituesit e landfilldit në vlerën 6 milion USD, si dhe njëkohësisht janë edhe kontribuues të buxhetit të KQ dhe indirekt edhe të shoqërisë “B...D”, ti kërkohet njësitë vendore, të bëhen ortak aksionare të kësaj shoqërie me pjesëmarrje proporcionale kuotash, për secilën njësi vendore.

Menjëherë

6. Gjetje. Në qershor të vitit 2013 është nënshkruar marrëveshja e grandit midis KQV dhe Programit IADSA për financimin e Projektit “*Sistemi social i bazuar në komunitetin e Qarkut Vlorë*”. Marrëveshja është në shumën 77.227.672 lekë, nga të cilat 64,380,418 lekë do të përballohen nga fondet e programit dhe 12.847.254 lekë përbëjnë financimin nga KQV. Ky projekt është fituar në partneritet me: Komunën Qendër, Bashkinë Himarë, Bashkinë Sarandë, Bashkinë Delvinë, Bashkinë Selenice, Drejtorinë e Shërbimeve Sociale Rajonale Vlorë dhe Komunën e Bolonjës, Itali. Afati i implementimit të tij është 18 muaj. Ky projekt ka filluar zbatimin e tij më datën 12 qershor të vitit 2013. Më datë 26.06.2013 është bërë transferimi i transhit të parë në vlerën 16,095,105 lekë. Deri në 01.04.2014 e gjithë shuma e disbursuar sipas konfirmimit bankar është shpenzuar, për blerje, pajisje e mobilie në vlerën 3,897,840 lekë, për blerje autovetura në vlerën totale 4.168.300 lekë dhe për pagat e punonjësve të projektit në vlerën totale prej 6,236,273 lekë. Blerjet e pajisjeve dhe autoveturave janë kryer me procedura të drejtpërdrejta sipas udhëzimeve të prokurimeve të donatorit të cilat lejojnë kryerjen e kësaj procedure për vlera më të vogla se 60.000 €, ndërsa për rekrutimin e punonjësve u konstatua se:

1. Në përfundim të procedurës së konkurrimit në datën 30.09.2013 u lidhën 4 kontratat e para të stafit që do të punojnë në projekt. Përzgjedhja e tyre është pranuar dhe konfirmuar nga donatori. Në fund të janarit 2013, për shkak të dorëheqjes nga puna të Shefes së Zyrës Rajonale Vlorë, vendi i lirë u ri-shpall përsëri dhe në datën 03.03.2014, është lidhur kontrata e re e punësimit. Kjo procedurë dhe kontrata e punësimit u dërgua për të marrë miratimin e donatorit, por donatori nuk e miratoi këtë procedurë dhe kërkoi dokumentacion shtesë për ta konsideruar procedurën e plotë.

2. Janë përzgjedhur edhe 25 punonjës të tjerë socialë. Sipas marrëveshjes, kontratat e tyre të punës u lidhen fillimisht për një periudhë prove 3 mujore, më pas në datën 03.03.2014 u lidhën për një periudhë 12 mujore. Procedura e përzgjedhjes së këtyre punonjësve, ndryshe nga procedura e përzgjedhjes së ekspertëve, nuk është dërguar për të marrë

miratimin e donatori të projektit. Megjithëkëtë, donatori ka pranuar në heshtje kontraktimin e këtyre punonjësve, duke vazhduar me zbatimin e projektit dhe deri në 01.04.2014 ka lejuar të kryhen pagesa nga llogaria e projektit. Në vijim, në datën 03.04.2014 përfunduan procedurat e përzgjedhjes dhe u lidhën 6 kontratat e punësimit për pozicionet, operator call center, Ekspert IT, Gjereatrik dhe Psikologe. Edhe për këta punonjës, praktikat e përzgjedhjes dhe kontratat e punësimit nuk u dërguan për të marrë miratimin e donatorit.

3. Në përfundim të 80% të shumës së kështit të parë të disbursimit, gjatë periudhës mars-maj 2014, menaxherja e projektit, i ka dërguar donatorit, dokumentet justifikues të shpenzimeve dhe ka kërkuar disbursimin e kështit të dytë. Ndërkohë siç u tha edhe më sipër deri në 01.04.2014 që është pagesa e fundit të disbursimit të parë, në dosjen e projektit nuk ka ndonjë dokument të donatorit që të kontestojë apo të bëjë vërejte për keq menaxhim të projektit, përveç rastit të sipërcituar të procedurës së punësimit të Shefit të Zyrës Rajonale, Vlorë. Por, Donatori me shkresën nr. 187, datë 09.06.2014, i drejtohet Kryetarit të KQV të sapo emëruar (në datë 04.06.2014) dhe e njofton për ndërprerjen e projektit. Shkresa ka këtë përmbajtje: *“...në mbledhjen e datës 06 Qershor 2014, Komiteti i Menaxhimit ka vendosur të mbyll në mënyrë të menjëhershme kontratën e Financimit. Faktikisht, KM ka evidenca se, Enti Ekzekutues ka kryer gabime të konsiderueshme dhe parregullsi gjatë implementimit të projektit, mes të tjerash, për ngarkesa debie të parregullta të përsëritura në Nr.e llogarisë së Projektit, emërimi i stafit të papërshtatshëm në projekt, i quajtur “Drejtor i Zyrës Rajonale Vlore”, vonesa të pajustificueshme në raportime sipas detyrimeve kontraktuale dhe, përveç kësaj, mungesë i një koordinimi të kënaqshëm midis Partnerëve gjatë menaxhimit të projektit.*

4. Siç tregon edhe përmbajtja e kësaj letre, përveç sa u trajtua më lartë është ngritur pretendimin edhe për ngarkesë debie të parregullt në llogarinë e projektit. Por, kjo pagesë në vlerën 315, 560 lekë është kryer gabimisht për llogari të një kompanie “J...a T...l & T...s”), gabim i cili sipas konfirmës bankare të datës 27.02.2014 është korrigjuar po nga vetë stafi i projektit duke e rikthyer këtë shumë në llogari të projektit. Në vijim mbylljes së projektit, mbas marrjes së shkresës nga donatori, Kryetari i KQV, i zgjedhur rishtas në datën 04.06.2014, ka pranuar në heshtje mbylljen e projektit dhe nuk ka bërë përpjekjet e duhura në përmbushje të detyrës së tij. Nuk ka njoftuar dhe kërkuar pranë Ministrisë e Financave që të ndërhynte për të evituar mbylljen e parakohshme të projektit. Po kështu nuk i ka kërkuar donatorit arsyet dhe shkaqet e mbylljes dhe më pas të nxirrte përgjegjësitë dhe të merrte masat administrative apo ligjore për punonjësit përgjegjës për mos disbursimin dhe mospërdorimin e **48,284,895 lekë fondeve të dhuruara (grande)**. Por është mjaftuar vetëm me negociimet që ka bërë me 26 punonjësit e kontraktuar të projektit. Kështu në datën 29.07.2014 ka lidhur një marrëveshje me këta punonjës për ndërprerjen kontratave të punës dhe për kryerjen e pagesave të prapambetura për pagat e 3 muajve të fundit të projektit, në vlerën totale prej 2,747,797 lekë. Nga veprimet apo mosveprimet, e ish-Kryetarit dhe Kryetarit KQV, nuk u arrit të shpenzohej e gjithë vlera e grandit prej 64,380,418 lekë, por janë shpenzuar vetëm 18,842,902 lekë ose se 29.3 %, **duke mos disbursuar dhe mos përdorur vlerën e mbetur prej 45,537,515 lekë, në përfitim të buxhetit të OKV, dhe në dobi të komunitetit të këtij Qarkut.**

6.1.Rekomandim: Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë, të marrë iniciativën dhe të bashkëpunojë me Ministrinë e Financave, për të negociuar përsëri me donatorin për të bërë të mundur fillimin e financimit dhe zbatimin e plotë të projektit.

Menjëherë

7. Në 25 gusht 2014 është nënshkruar kontrata ndërmjet, KQV dhe Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, për financimin me grand të Projektit “Rritja e Prodhimit të vajit të Ullirit me përdorimin e Teknologjisë Inovative të Informacionit dhe Komunikimit”. Marrëveshja është në shumën 149,304.44 Euro, nga të cilat 126,908 Euro do të përballohen nga donatori dhe 22,395 Euro nga KQV. Ky projekt është fituar në partneritet me: Këshillin e Qarkut Ionina Korfuz, Greqi, Qendrën e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore Vlorë dhe me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë, Vlorë. Afati i implementimit të projektit është 24 muaj. Me datë 26.01.2015 është transferuar transhi i parë në vlerën 2,473,334 lekë. Deri në 30.09.2015 janë kryer shpenzime për zbatimin e projektit në vlerën 2,057,496 lekë, për pagat e punonjësve aktual të KQV në shumën totale prej 429,160 lekë, për pagat stafit të projektit në shumën totale prej 713,000 lekë, për udhëtime dhe dieta në shumën 221,046, për blerje pajisje, broshura dhe fletëpalosje në vlerën totale 694,290 lekë. Të gjitha blerjet janë bërë të drejtpërdrejta në përputhje me udhëzimet e donatorit dhe marrëveshjen e grandit. U konstatua se:

Në zbatim të marrëveshjes së grandit, në përfundim të procedurës së konkurrimit janë lidhur 3 kontrata për punësimin e ekspertëve që do të merren me implementimin e projektit. Përveç këtyre ekspertëve, në bazë të urdhrave të Kryetarit të KQV, janë ngarkuar për zbatimin e projektit edhe 4 punonjës të administratës së KQV. Këta punonjës deri në datën 31.08.2015, përveç pagës së punës që kanë marrë nga ushtrimi i detyrave të tyre funksionale janë paguar edhe nga fondet e projektit, duke shkaktuar kështu, dëm ekonomik në vlerën **totale 429,000 lekë**. Ky veprim është në kundërshtim me, marrëveshjen e financimit dhe me VKM nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit të Institucioneve buxhetore”.

7.1.Rekomandim: Punonjësit e administratës së KQ, Vlorë që janë ngarkuar për zbatimin e projektit të mos paguhen nga fondet e projektit, por këtë punë ta kryejnë në funksion të detyrave të tyre funksionale.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitet e Sektorit Publik” nga ana e Kryetarit të Këshillit të Qarkut Vlorë, me cilësinë e nëpunësit autorizues, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, **shpërblimin e demit në vlerën e përgjithshme rreth 4,560,000 lekë**, si me poshtë:

1. Gjetje. Në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në nenin 1, të Ligjit nr. 10160 datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civil”, ish- Kryetari i KQV, për periudhën nga 1 Janari deri më 31 Tetor të vitit 2013, ka përfituar, padrejtësisht trajtim financiar në formë bonusi për shërbimin e transportit, në vlerën totale prej 315,000 lekë.

1.1. Rekomandim. Të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për ti kërkuar: z. A.DH. me detyrë ish-Kryetar i Këshillit të Qarkut Vlorë, **shpërblimin e demit në vlerën 315,000 lekë**.

Menjëherë

2. Gjetje. Nga data 01.01.2013 deri në datën 31.10.2014, janë tërhequr nga magazina e institucionit sasia prej 5,226 litra karburant i llojit dissel me vlerë 948,721 lekë, për mjetin në përdorim të ish-Kryetarit të KQV. Për të gjithë këtë sasi të konsumuar, nuk ka asnjë flet udhëtimi, apo dokument tjetër, për të justifikuar destinacionin e shpenzimit të kësaj sasive karburanti, në kundërshtim me neni 5 të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 8, 7, 10, 34, 35 “Dokumentet vërtetues”.

2.1. Rekomandim. Të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për ti kërkuar: z. A.DH., me detyrë ish-Kryetar i Këshillit të Qarkut Vlorë dhe R.XH, me detyrë ish-shofer i Kryetarit të KQV, *shpërblimin e dëmit në vlerën 948,721 lekë.*

Menjëherë

3. Gjetje. Me urdhër të Kryetarit të KQV, nga data 01.01.2015 deri në datën 30.10.2015 e gjithë sasia karburanti “diesel”, prej 10,200 litra në vlerën totale prej 1,666,140 lekë është shpërndarë dhe përdorur nga mjetet në pronësi personale të 11 (njëmbëdhjetë) punonjësve të administratës së KQV dhe dy mjeteve në pronësi të institucionit. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 10.160 datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publik dhe nëpunësit civil”, i cili përcakton se: *“Kategoria e katërt, ku përfshihen të gjithë punonjësit e tjerë të ministrive, institucioneve qendrore dhe të varësisë, shërbimi i transportit për përmbushjen e detyrave funksionale, do t'u ofrohet nga institucioni përkatës. Ky shërbim do të kryhet me mjetet në përdorim të institucionit, të cilat përdoren, në çdo rast, vetëm me autorizim apo urdhër të titullarit, për shërbime, sipas një programi të miratuar prej tij”.*

3.1. Rekomandim: Këshilli i Qarkut Vlorë (Drejtoria e Financës), referuar tabelës së pasqyruar në procesverbalin nr. 2, datë 04.12.2015 të mbajtur nga auditimi, të saktësojë dhe të kryej përlllogaritjet e sasive të karburantit të harxhuar me nga 11 (njëmbëdhjetë) punonjësit e administratës së KQV, sipas çmimeve periodike. Mbas llogaritjeve, të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për ti kërkuar, *11(njëmbëdhjetë) punonjësve shpërblimin e dëmit të shkaktuar në vlerën totale të përafërt rreth 800,000 lekë, e ndarë kjo, sipas vlerave të llogaritura për sasi të përkatëse të karburantit që ka harxhuar secili punonjës.*

Menjëherë

4. Gjetje. Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren të objektit “Rikonstruksioni i Rrugës së Varrezave të Qytetit Vlorë” me vlerë kontrate 22,178,175 lekë, të prokuruar në vitin 2012 dhe të përfunduar në fillim të vitit 2013, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera dhe të likuiduara në vlerën 791,908 lekë. Ky veprim bie në kundërshtim, me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, me neni 4 dhe neni 6 pika 1 të Udhëzimit nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, dhe me pikën 3.2 dhe 3.3 kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur ndërmjet Këshilli i Qarkut Vlorë dhe mbikëqyrës të punimeve “S...K”.

4.1. Rekomandim: Të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për ti kërkuar operatori ekonomik “S...K”, *shpërblimin e dëmit në vlerën 791,908 lekë.*

Menjëherë

5. Gjetje: Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren të objektin “Përmirësimi i Kushteve të Banesave për Komunitetin Rom-Egjiptian” me vlerë kontrate **4,933,067** lekë, të përfunduar në vitin 2015, në Komunat, Novoselë dhe Shushicë, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera dhe të likuiduara në vlerën 772,255 lekë. Ky veprim bie në kundërshtim, me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, me neni 4 dhe neni 6 pika 1 të Udhëzimit nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, dhe me pikën 3.2 dhe 3.3 kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur ndërmjet Këshilli i Qarkut Vlorë dhe mbikëqyrës të punimeve “C...O”.

5.1. Rekomandim: Të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për ti kërkuar operatori ekonomik “C...O”, *shpërblimin e dëmit në vlerën 772,255 lekë.*

Menjëherë

6. Gjetje: Për zbatimin e kontratës së lidhur në datën 25.10.2014 ndërmjet KQV dhe Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, për financimin me grand të Projektit “Rritja e Prodimit të vajit të Ullirit me përdorimin e Teknologjisë Inovative të Informacionit dhe Komunikimit” në shumën 149,304.44 Euro, përveç stafit të jashtëm të kontraktuar nga KQV, me Urdhër të Kryetarit janë ngarkuar për zbatimin e projektit edhe 4 punonjës të administratës së KQ. Këta punonjës deri në datën 31.08.2015, përveç pagës së punës që kanë marrë nga ushtrimi i detyrave të tyre funksionale janë paguar edhe nga fondet e projektit, duke shkaktuar kështu, dëm ekonomik në vlerën **totale 429,000 lekë**, në kundërshtim me, marrëveshjen e financimit të sipërcituar dhe me VKM nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit të Institucioneve buxhetore”.

6.1. Rekomandim: Të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për ti kërkuar: *znj. V.A., me detyrë zëdhënëse e Këshillit të Qarkut, shpërblimin e dëmit në vlerën 84,770 lekë lekë.*

Menjëherë

6.2. Rekomandim: Të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për ti kërkuar: *z. B.L. me detyrë, Drejtor Kabineti i Këshillit të Qarkut, shpërblimin e dëmit në vlerën 130,415 lekë.*

Menjëherë

6.3. Rekomandim: Të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për ti kërkuar: *znj. J.XH. me detyrë Drejtore e Financës së Këshillit të Qarkut, shpërblimin e dëmit në vlerën 77,927 lekë.*

Menjëherë

6.4. Rekomandim: Të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për ti kërkuar: *z. K.GJ. me detyrë Këshilltar Ligjor në Këshillin e Qarkut, shpërblimin e dëmit në vlerën 70,745 lekë.*

Menjëherë

C. MASA PËR PËRDORIMIN ME EFEKTIVITETE TË FONDEVE

1. Gjetje: Në procedurën “Pikë panoramike dhe sportive në Llogora” me fond limit 14,094,359 lekë, AK ka hartuar dhe vendosur në DT të këtyre procedurave, kriteret e veçanta kualifikuese. Disa nga këto kriteret nuk janë përcaktuar në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën kontratës që do të prokurohet dhe janë diskriminuese, sepse janë hartuar teje të fryra dhe kufizuese si dhe nuk stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm. Veprime këto, në kundërshtim, me rregullat e prokurimit publik. Këto shkelje janë bërë shkak që KVO-ja gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave ka s`kualifikuar operatorët, “B...3”, “Gj...a” dhe JV “Sh...i&F...i”, të cilët kanë paraqitur ofertat më të ulëta ekonomikisht se operatori fitues “A...i”, me diferencë të që shkon nga lekë 246,791 lekë, në 1,924,282 lekë. Si pasojë e këtyre shkelje ka rezultuar impakt negativ me rritje fiktive të fondeve në vlerën **2,309,138, lekë**.

1.1. Rekomandim: Këshilli i Qarkut Vlorë, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike **në vlerën 2,309,138, lekë**.

Menjëherë

2. Gjetje. Në procedurën “Krijimi i një shtegu Trekking në Kanionin e Gjipesë”, me fond limit në vlerën 7,837,835 lekë, AK ka hartuar dhe vendosur kriteret e veçanta në kundërshtim, me rregullat e prokurimit publik. Këto, shkelje janë bërë shkaqe për s`kualifikime e të gjithë operatoreve pjesëmarrës (4 operatorë) në këtë procedurë, për pasojë nuk është siguruar konkurrenca, duke e çuar këtë procedurë në anulimin e saj. Po kështu është vepruar edhe në procedurën e përsëritur, duke e çuar përsëri këtë procedurë në anulim. AK, nuk ka analizuar shkaqet, që shkaktojnë dështimin e procedurës së parë, dhe nuk ka korigjuar kërkesat e veçanta në mënyrë, që të bëjë të mundur rritjen e konkurrencës, pasi kriteret e veçanta të përcaktuara në DT në të dy procedurat vijuese janë të njëjta si të procedurës së parë, çka ka bërë që procedura të anulohet dy herë rresht dhe të realizohet mbas herës së tretë ose mbas 50 ditëve, në vend që të realizohej mbas 10 ditëve, në kundërshtim, me rregullat e prokurimit publik. Nga këto veprime apo mosveprime nuk është përmbushur qëllimi i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” në lidhje me mirë përdorimin e fondeve, pasi nuk janë përdorur me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet fonde publike me vlerë **361,578 lekë**. Kjo vlerë llogaritet si diferencë e vlerës së ofertës ekonomike të operatorit fitues “M...S”, me diferencën e vlerës së ofertës ekonomike të operatorit “S...K”, i cili u s`kualifikua nga KVO padrejtësisht në procedurën e parë të datës 15.06.2015, sepse nuk plotësonte disa kërkesa të veçanta të vendosura në DK të cilat nuk ndikonin në ekzekutimin e kontratës.

2.1. Rekomandim: Këshilli i Qarkut Vlorë, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve publike **në vlerën 361,578 lekë**.

Menjëherë

Ç. MASA DISIPLINORE

I. Mbështetur në nenin 54, në pikën 1 dhe 2 të nenit 55 dhe në pikën 2 të nenit 58, të Kreut IX të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i rekomandojmë, **Këshillit të Qarkut Vlorë:**

Të vlerësojë, shkallën e përgjegjësisë për të gjitha mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në varësi të kësaj analize të vendosë masa konkrete për punonjësit e shkaktarë përgjegjës.

II. Mbështetur në germën “dh” të nenit 60, të Kreut IX të ligjit Nr.8652, datë 31.7.2000 “Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i rekomandojmë, **Kryetarit të Këshillit të Qarkut Vlorë:**

Të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësisë, shkallën e përgjegjësisë për mangësitë dhe shkeljet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe të filloi procedurat për dhënien e masave disiplinore:

Nga “Vërejtje” deri në “Largim nga puna”, për:

z. B.L. me detyrë, Drejtor i Kabinetit të Kryetarit të i Këshillit të Qarkut, sepse:

-Me cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në procedurat e prokurimit: “Pikë panoramike dhe sportive në Llogora” me fond limit 14,094,359 lekë dhe “Krijimi i një shtegu Trekking në kanionin e Gjipesë”, me fond limit në vlerën 7,837,835 lekë, të realizuara në vitin 2015, ka vepruar në kundërshtim, me bazën ligjore dhe nënligjore që rregullon fushën e Prokurimit Publik, në lidhje me mirë përdorimin e fondeve, pasi nuk ka përdorur me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet fonde publike me vlerë **2,670,716 lekë.**

-Gjithashtu, nga pozicioni zyrtar i tij, Drejtor i Kabinetit të Kryetarit të i Këshillit të Qarkut, përveç pagës së këtij funksioni, ka përfituar privilegje financiare të ligjshme dhe privilegje të tjera financiare të paligjshme që së bashku shkojnë pothuajse edhe njëherë sa paga e funksionit të tij, konkretisht:

-Ka vepruar, në kundërshtim me Ligjin nr. 10160 datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publik dhe nëpunësit civil”, sepse për periudhën janar-tetor 2015 ka përfituar padrejtësisht për automjetin e tij personal në formë bonos 1,450 litra karburant duke shkaktuar **dëm ekonomik i cili llogaritet afërsisht në vlerën 202,000 lekë.**

- Ka vepruar në kundërshtim me, marrëveshjen e financimit të lidhur në datën 25.10.2014 ndërmjet KQV dhe Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, për financimin me grand të Projektit “Rritja e Prodimit të vajit të Ullirit me përdorimin e Teknologjisë Inovative të Informacionit dhe Komunikimit” dhe me VKM nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit të Institucioneve buxhetore”, sepse për periudhën shtator 2014- gusht 2015, përveç pagës së punës që kanë marrë nga detyra e Drejtorit të Kabinetit; është paguar dhe ka përfituar padrejtësisht fonde nga projektit për çdo muaj në shumën 100 Euro dhe në total për gjithë këtë periudhë ka përfituar **130,415 lekë në dëm të buxhetit të projektit.**

-Përveç sa më lart, me statutin e Shoqërisë Aksionare “B...D” të datës 19.11.2014 të miratuar nga aksionari i vetëm Këshilli i Qarkut Vlorë, përfaqësuar nga Kryetari, është emëruar edhe Kryetar i Këshillit Administrativ të kësaj shoqërie. Me këtë cilësi edhe pse nuk është në shkelje të ligjit përfiton shpërblim në masën 25,000 lekë për çdo muaj dhe për gjithë periudhën dhjetor 2014-tetor 2015, **do të përfitojë edhe 275,000 lekë** të tjera (kjo pagesë deri në momentin e auditimit nuk është kryer nga shoqëria për mungesë fondesh).

D. VLERËSIMI DHE MBIKËQYRJA E ZBATIMIT TË MASAVE

I. Në mbështetje të nenit 54 “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit të Qarkut” dhe të germës “f” “organizimin dhe mbikëqyrjen e kontrollit të brendshëm” të Kreut IX të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i rekomandojmë:

1. Kryetarit të Këshillit të Qarkut Vlorë, që në mbedhjen më të afërt të Këshillit të Qarkut, të fusë në rend dite, analizimin dhe shqyrtimin e masave të rekomanduara dhe mangësive dhe shkeljeve, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

2. Këshilli i Qarkut Vlorë, në përfundim të analizës së përgjegjësisë të dali me vendim të veçantë, duke përcaktuar afatet konkrete dhe strukturat përgjegjëse të administratës së Këshillit të Qarkut që do të merren me ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të rekomandimeve.

II. Në mbështetje të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH do të ndjek me vëmendje të veçantë dhe do të vlerësojë marrjen e masave, që do të marrë Këshilli i Qarkut Vlorë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, reflektimin e tyre në përmirësimin e proceseve të veprimtarisë ekonomiko financiare, me qëllim mirë përdorimin e fondeve publike, në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit.

Në përfundim të afateve të përcaktuara në rekomandimet e dërguara dhe afatin e caktuar 6 muaj, në nenin e sipërcituar, do të kryejmë auditim të veçantë, për ecurinë dhe nivelin e zbatimit të masave të rekomanduara.

E. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

KLSH do të ndjek me vëmendje të veçantë dhe vlerësojë dhe marrjen e masave, që do të marrë Këshilli i Qarkut Vlorë për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga auditimi i kryer, reflektimin e tyre në përmirësimin e proceseve të veprimtarisë ekonomiko financiare, me qëllim mirë përdorimin e fondeve publike, në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit në shërbim të komunitetit.

Në përfundim të afateve të përcaktuara në rekomandimet e dërguara dhe afatin e caktuar 6 muaj, në nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, do të kryejmë auditim të veçantë, për ecurinë dhe nivelin e zbatimit të masave të rekomanduara.

Nga Këshilli i Qarkut Vlorë, nuk është kthyer përgjigje akoma, së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, pasi nuk është ezauruar afati ligjor prej 20 ditë, pra rezulton se rekomandimet janë në proces vlerësimi.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Bashkim Arizaj, Përparim Gjuzi, Mirosh Bogdo, Genci Koka dhe Taulant Dervishaj, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Xhaferr Xhoxhaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT